

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 21.06.2018]

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Nika" shpk (30,4%) & "Vashtemia" shpk (54,8%) & "Sterkaj" shpk (14,8%), perfaqesuar nga shoqeria "Nika" shpk, me adrese: Lagja "Vasil Shanto", Bulevardi "Skenderbeu", godine 8 kateshe, kati i pare, Zona kadastrale 8593, nr. Pasurie 5/587, Shkoder, me NIPT J76705047U.

Procedura e prokurimit: **"Tender i Hapur"** me objekt : **"Riveshje me asfalt e rrugës kryqëzimi Shëngjin - Qyteti Shëngjin - Porti Ushtarak"**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Riveshje me asfalt e rrugës kryqëzimi Shëngjin - Qyteti Shëngjin - Porti Ushtarak"**.

Numri i referencës së procedurës: REF-67264-05-04-2018.

Kohëzgjatja: brënda 1 muaji nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 58.147.418 (pesedhjetë e tete milion e njeqind e dyzet e shtate mije e katerqind e tetembdhjetë) lekë pa tvsh. Fondi i akorduar për vitin 2018 është 14.000.000 (katermbdhjetë milion) lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2019.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 06.06.2018.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	NIPTI	OFERTA PA TVSH
1	"Nika" shpk (30,4%) "Vashtemia" shpk (54,8%) "Sterkaj" shpk (14,8%)	J76705047U J64103054Q J68310708M	37,169,610
2	"Bami" shpk 65% "Be-is" shpk 35%	J94416206R K71412003A	39,511,356
3	"Company Riviera 2008" shpk "Agri konstruksion" shpk "Kacdedja" shpk (23,67%)	K81716011V K01725001F K51712017A	41,998,308
4	"Junik" shpk	J68007522L	45,897,418
5	"Gjoka Konstruksion" sha	J91815014U	45,978,376
6	"Arifaj" shpk 90% "Ekskluziv" shpk 10%	J76418907K J69102021W	46,001,901
7	"Varaku E" shpk	J61902509S	NUK KA PARAQITUR OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Bami" shpk (65%) dhe "Be - Is" shpk (35%) pasi:

Shoqeria "Be - Is" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim "Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese propozimin e tij me emrin e inxhinierit per secilin post, shoqeruar me dokumentacion qe provon se ka si te punesuar dhe te regjistruar ne kompanine e tij:

2 (dy) inxhinjere ndërtimi

1 (një) inxhinier mekanik

2 (dy) inxhinier topograf

1 (një) inxhinier mjedisi

Per secilin inxhinier te propozuar do te paraqese edhe diplomë, kontratë pune te vlefshme dhe CV" pasi sipas marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper 100% te punimeve te germimit e te mbushjes, 100% te punimeve shtrese betoni per kuneta, 100% te punimeve shtrese cakelli mbeturine kave, 100% te punimeve te sinjalistikes por nuk ka ing topograf (i domosdoshem per kryerjen e punimeve ne kunatat e betonit, germimeve dhe mbushjes) dhe nuk ka ing. Mekanik, i domosdoshem per kryerjen e punimeve per vendosjen e tabelave te sinjalistikes.

Shoqeria "Be - Is" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi sipas marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper 100% te punimeve te germimit e te mbushjes, 100% te punimeve shtrese betoni per kuneta, 100% te punimeve shtrese cakelli mbeturine kave, dhe, referuar shtojces 10 (deklarates per disponimin e mjeteve), nuk disponon asnje ekskavator, greider, dhe asnje autobetoniere. Pa keto mjete nuk eshte ne gjendje te kryeje punimet qe ka marre persiper.

2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Arifaj" shpk (90%) dhe "Ekskluziv"

shpk (10%) pasi:

Shoqeria “Ekskluziv” shpk nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me paraqitjen e vetedeklarimit per plotesimin e kerkesave te Pergjithshme per Kualifikim, pasi nuk e ka paraqitur kete deklarate.

Shoqeria “Ekskluziv” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.3 per kualifikim *“Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese propozimin e tij me emrin e inxhinierit per secilin post, shoqeruar me dokumentacion qe provon se ka si te punesuar dhe te regjistruar ne kompanine e tij:*

2 (dy) inxhinjere ndërtimi

1 (një) inxhinier mekanik

2 (dy) inxhinier topograf

1 (një) inxhinier mjedisi

Per secilin inxhinier te propozuar do te paraqese edhe diplomë, kontratë pune te vlefshme dhe CV” pasi sipas marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper 100% te punimeve te germimit e te mbushjes si dhe punime shtresash dhe nuk ka ing topograf, i domosdoshem per kryerjen e ketyre punimeve.

Shoqeria “Ekskluziv” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.5 per kualifikim “Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij nga tetori 2017 e ne vazhdim mjekun e shoqerise, ne zbatim te VKM nr. 742, date 06.11.2003. Per kete duhet te paraqese kontraten e punes, diplomen dhe licensen perkatese” pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per te vertetuar plotesimin e ketij kushti.

3. **Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Varaku E” shpk pasi:** nuk ka paraqitur asnje dokumentacion.
4. **Ploteson kerkesat per kualifikim** Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "Nika" shpk (30,4%) & "Vashtemia" shpk (54,8%) & "Sterkaj" shpk (14,8%).
5. **Ploteson kerkesat per kualifikim** Bashkimi i Operatoreve Ekonomike "Company Riviera 2008" shpk (42%) & "Agri konstruksion" shpk (34,33%) & "Kacdedja" shpk (23,67%).
6. **Ploteson kerkesat per kualifikim** Operatori Ekonomik “Junik” shpk.
7. **Ploteson kerkesat per kualifikim** Operatori Ekonomik “Gjoka Konstruksion” sha.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Nika" shpk (30,4%) & "Vashtemia" shpk (54,8%) & "Sterkaj" shpk (14,8%), perfaqesuar nga shoqeria “Nika” shpk, me adrese: Lagja “Vasil Shanto”, Bulevardi “Skenderbeu”, godine 8 kateshe, kati i pare, Zona kadastrale 8593, nr. Pasurie 5/587, Shkoder, me NIPT J76705047U.**

se oferta e paraqitur, me vlerë **37,169,610 (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë** pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**

- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **13.06.2018**.

Nuk jane paraqitur ankesa per kete procedure.

